

Fletore e Demokracisë

Etika dhe Zgjedhjet

Fletore e Demokracisë

Etika dhe Zgjedhjet



Lejohet prezantimi, kopjimi dhe shpërndarja e librit në tërësi apo në pjesë, me kusht që: (a) materialet të përdoren duke i njohur USAID-it dhe NDI-së autorësinë e botimit, (b) ky libër do të shërbejë vetëm për përdorim informativ, jo-tregtar dhe personal, (c) të mos bëhen modifikime të këtij libri.

Ky libër u mundësua përmes mbështetjes së ofruar nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) nën Marrëveshjen Bashkëpunuese (Cooperative Agreement) Nr. 182-A-00-04-00104-00 me NDI.

Opinionet e shprehura në këtë botim janë të vetë autorëve dhe si të tilla nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID.

Anëtarët e bordit botues janë vullnetarë dhe veprojnë si individë privatë, dhe ata janë:

Prof. Dr. Rexhep Meidani, ish-President i Republikës së Shqipërisë; Sabri Godo, President i Asamblesë Kombëtare të Partisë Republikane; Andrea Stefani, Këshilltari i Lartë për Median, Konsorciumi DGA/IREX; Barry Reed, Drejtor, Qeveria Lokale dhe Decentralizimi në Shqipëri (USAID); Gent Ibrahim, Drejtir Ekzekutiv, Instituti për Politikat & Studime Ligjore; Ilir Aliaj, Drejtor Ekzekutiv, Qendra për Zhvillimin & Demokratizimin e Institucioneve; Pjerin Marku, Drejtor Ekzekutiv, Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit; Dr. Teuta Starova, Shefe e Departamentit Filozofi-Sociologji, Universiteti i Tiranës. Jennifer L. Butz, Drejtoresh e Konsorciumi DGA/NDI; Aleksandër Çipa, Konsorciumi DGA/IREX; Dan Redford, Këshilltari i Lartë për Partitë Politike dhe Procesin Zgjedhor, Konsorciumi DGA/NDI.

Botuar nga Shtëpia Botuese “PEGI”

Rruga e Elbasanit, Pallatet Fratari, Filipeu Nr.2, Tiranë

Tel: +04 374947

Fax: +04 374947

Përgatitur nga National Democratic Institute for International Affairs

Faqesja: Erald Velmishi

ISBN: 99943-705-6-1



Përmbajtja

• Parathënia	VI
• Dy fjalë për kontribuesit	VIII
1. Eetika dhe demokracia <i>Erion Kristo</i>	1
2. Kultura e gruas dhe lëvizja feministe drejt politikës <i>Miranda Haxhia</i>	9
3. Etika, kultura e komunikimit dhe roli i medias <i>Zimo Krutaj</i>	14
4. Vezhgimi i zgjedhjeve <i>Dan Redford, Etleva Qinami dhe Eduard Ostrosi</i>	21
5. Monitoruesit e partive politike <i>Sue Nelson</i>	27
6. Monitorimi medias në zgjedhet <i>Robert Norris dhe Patrick Merloe</i>	31
7. Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA)	37

Parathënie

Në këtë vëllim të dytë të *Fletores së Demokracisë*, ne do të vazhdojmë temën e zgjedhjeve dhe të etikës. Gjashtë artikujt e këtij vëllimi i drejtohen aspekteve teorike dhe praktike të zgjedhjeve të cilat i bashkojnë me ngjarjet aktuale të lidhura me zgjedhjet e ardhshme në Shqipëri. Ky numër i *Fletores* ndahet në dy pjesë: tre artikujt e parë i drejtohen aspekteve specifike të demokracisë: etikës, pjesmarrjes së gruas, dhe medias. Shkrimet e tjera i drejtohen përpjekjeve të monitorimit të zgjedhjeve të para në tre drejtime.

Në artikullin e parë, Erion Kristo argumenton se Shqipëria është ende në tranzicion drejt një sistemi demokratik të qeverisjes që pushteti mbetet në duart e një pakice të vogël. Ai vëren që nuk është e mjaftueshme të kesh një strukturë ligjore; demokracia gjithashtu kërkon një kuptueshmëri të mirë se si të zbatojmë dhe monitorojmë ligjet.

Miranda Haxhia në artikullin e dytë jep një analizë teorike të pjesmarrjes së gruas në politikën shqiptare. Haxhia vëren cilësitë e veçanta të karakterit shqiptar që gjithashtu ndikojnë në mbajtjen e grave larg qarqeve politikë. Ajo vëren se janë gratë të cilat duhet të luftojnë dhe të sigurojnë rolin e tyre të plotë në jetën politike shqiptare.

Artikulli vijues, i shkruar nga Zimo Krutaj, është një shkrim i gjallë i titulluar Etika, Kultura e Komunikimit dhe Roli i Medias. Ai

sugjeron se dialogu politik aktual ka më tepër të bëjë me nxjerrjen në pah të argumentit të dikujt sesa me komunikimin e ideve dhe alternativave të politikave. Krutaj, insiston që përgjegjësia për këtë situatë bie mbi qarqet politike si dhe ato mediatike.

Në gjysmën e dytë të *Fletores së Demokracisë*, kontribuesit i kushtojnë vëmendje rëndësisë së monitorimit të zgjedhjeve. Autorët shpjegojnë me hollësi rolin e monitoruesve të pavarur, rolin e vëzhguesve partiakë dhe monitorimin e medias. Këto artikuj mbështeten në kodin aktual zgjedhor të Shqipërisë, si edhe normat më të gjera ndërkombëtare për monitorimin e pavarur të zgjedhjeve. Një temë e cila përshkron secilin prej këtyre shkrimeve është ekuilibri ndërmjet të drejtave dhe përgjegjësisë të të gjithë vëzhguesve.

Artikulli i parë në këtë segment është përgatitur nga vetë stafi NDI/Shqipëri. Dan Redford, Etleva Qinami, dhe Eduard Ostrosi hedhin një vështrim të gjerë drejt vëzhgimit të zgjedhjeve, etikës dhe profesionalizmit me të cilin vëzhguesit duhet të ndërmarrin detyrat e tyre. Artikulli dytë është një vazhdimësi nga *Fletorja Demokracia #1*, nga Sue Nelson i projektit ACE. Ky artikull shqyrton nga afër rolin dhe etikën e vëzhguesve partiakë. Artikulli i tretë në këtë grup është marrë nga një manual i NDI-së mbi monitorimin e medias gjatë zgjedhjeve, shkruar nga Robert Norris dhe Patrick Merloe, dhe servit masa përkatëse dhe praktike si dhe udhëzime me të cilat kontrollohet mbulimi mediatik gjatë periudhës zgjedhore.

Konsorciumi DGA dëshiron të falënderojë secilin prej kontribuesve të këtyre artikujve plot mendime dhe që që vijnë në një kohë të duhur, veçanërisht në një kohë kur Shqipëria futet në një periudhë të ethshme që shoqëron çdo periudhë zgjedhore. Ne mirëpresim pikpamjet e lexuesve përmesh letrave. Ju lutem dërgoni mendimet tuaja tek: *Fletorja e Demokracisë*, Projekti DGA, #41 Pjeter Bogdani, Tiranë (përballë Shkolles ish-11 Janar).

Jennifer L. Butz
Drejtoreshë Vendore, NDI/Shqipëri
Drejtoreshë e Konsorciumit, Demokraci dhe Qeverisje në
Shqipëri

Qershor 2005, Tiranë

Dy fjalë për kontribuesit

Erion Kristo

Filozof

Miranda Haxhia

Publiciste, shkrimtare

Zimo Krutaj

Filolog, Publicist

Dan Redford, Etleva Qinami dhe Eduard Ostrosi

Këshilltar i lartë për Proceset Politike dhe Zgjedhore, Këshilltare Lokale për Proceset Zgjedhore dhe Oficer Programi për Proceset Zgjedhore (NDI/Shqipëri)

Sue Nelson

Këshilltare e Pavarur e Zgjedhjeve

Robert Norris dhe Patrick Merlot

Eksperte për Zgjedhjet dhe bashkëpunëtorë i lartë dhe drejtor i programit për Zgjedhjet

1. Etika dhe demokracia

Erion Kristo

Demokracia është një sistem apo një regjim ku zbatohet një vendimmarrje kolektive e kontrolluar nga populli dhe ku garantohet barazia e të drejtave në ushtrimin e këtij kontrolli. Demokracia nuk lidhet vetëm me shtetin, i cili është një organizatë e përmasave të mëdha dhe gjithëpërfshirëse. Demokracia përfshin të gjitha sferat e jetës shoqërore, ndaj është me vlerë të flasim për një shoqëri demokratike, ku mbrohet liria individuale, ku sundon pluralizmi politik, ku vendos shumica dhe ku pakicat respektohen. Shoqëria demokratike mbështetet në ekonominë e tregut të lirë, në pronën private dhe në shtetin ligjor. Përveç këtyre, për një shoqëri vërtet demokratike, duhen zbatuar parimet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, koncepti i ndarjes së pushteteve, pavarësia e mediave, një shoqëri civile e zhvilluar, e shumë koncepte të tjera që lidhen drejtpërdrejtë me ushtrimin e pushtetit dhe kontrollin e tij. Pra, demokracia bazohet tek barazia e qytetarëve përpara ligjit, tek pluralizmi i ideve dhe tek diversiteti kulturor, duke garantuar liritë themelore të shtetasve. Në një farë mënyre, rendi demokratik mund të quhet rendi i etikës, ose më mirë mund të themi se i vetmi regjim etik është demokracia.

Vetë etika merret me kuptimin e jetës, me qëllimin e fundëm të jetës, me të mirën supreme, pa harruar gjithsesi etikën individuale. Një fakt i vuajtjes njerëzore, mund të shihet si diçka e thjeshtë që i ndodh dikujt ose si një klithmë padrejtësie, së cilës i përgjigjemi

me të gjithë qenien tonë. Dallimi midis këtyre dy gjërave varet nga përfytyrimi që kemi për to, nga ndjenjat që na lindin. Por ndjenjat janë objekt i përgjigjeve morale. Etika si disipline eksploron rrugët e ndryshme të kritikës morale. Arsyetimi është i rëndësishëm në zhvillimin e konceptimeve morale.

Sartri ka thënë: “Nuk mund të ekzistojë asnjë etikë, nëse nuk propozohet një koncept për lirinë”. Etika në përgjithësi ka të bëjë me marrëdhëniet me të tjerët, ndërsa morali lidhet thelbësisht me zërin e ndërgjegjes, në marrëdhënie me veten. Etika është e lidhur me kushtëzimet. Etikë nuk do të thotë “Rrasa guri” (si ato të Moisiut), por nevojë për rregulla. Etika luhet në pikën midis rregullave dhe zbatimit të tyre. Ajo formohet përmes zakoneve, traditave dhe mësohet qysh në vogëli përmes bindjeve. Parimi themelor i etikës është: “Alterum Non Ledere” (mos e çëno tjetrin). Liria dhe etika ecin krah për krah. Etika nuk është një këmishë force. Ta jetosh jetën në mënyrë të denjë, ky është një problem etik. Pra, për çfarë shërben etika? Ajo na shërben për të jetuar më mirë. Bota nuk mund të kuptohet pa rregulla, përndryshe nuk do të na ndahej gijotina. Etika është ilaçi ndaj të këqijave. Kemi nevojë për etikë dhe rregulla, pikërisht sepse njerëzit prirën t'i shkelin rregullat. Ndoth që njerëzit të sillen mirë sepse kanë frikë nga ndëshkimet. Ndërsa njeriu moral vepron pasi ka reflektuar dhe në përputhje me rregullat. Etika, e kuptuar si etikë publike, si etikë e qytetarit, është një gjë e rëndësishme.

Po si lidhet demokracia me etikën? Po rendisim disa veçori që karakterizojnë një sistem demokratik:

- padhunueshmëria e integritetit moral e fizik të personit;
- liria e mendimit, liria e shprehjes dhe liria e besimit;
- barazia e qytetarëve përpara shtetit;
- pjesëmarrja e qytetarëve në ushtrimin e pushtetit;
- garantimi i kushteve të nevojshme për një jetë dinjitoze; dhe
- shteti i së drejtës (shteti ligjor).

Pacënueshmëria e personit është kryekëput një parim që vjen nga etika, ngase çdo qenie njerëzore duhet të trajtohet si e tillë, ndaj dhe nuk mund të dhunohet. Madje, edhe një kriminel, pasi

provohet krimi i tij përmes një gjykimi të drejtë, duhet ta vuajë dënimin brenda disa kushteve të pranueshme në pikëpamjen njerëzore. Edhe veçoria e dytë, pra liria e mendimit, e shprehjes dhe besimit, mbart në vetvete elementin etik, sepse asnjë nga këto liri nuk mund të çënohet, mjaft që të mos çënojë lirinë e të tjerëve.

Veçoria e tretë, pra barazia përpara ligjit, është edhe ajo një element etik, sepse nuk duhet që të ekzistojnë rregulla që privilegjojnë një kategori njerëzish dhe diskriminojnë të tjerët. Barazia kërkon edhe pjesëmarrje të qytetarëve në ushtrimin e pushtetit. Askush nuk mund të gjendet përballë vendimarrjeve që nuk marrin parasysh opinionin e tij, sepse çënohet liria e tij. Parimi etik zbatohet edhe përsa u përket kushteve dinjitoze të jetesës, sepse nëse ato mungojnë, kjo është diçka amorale. Kush nuk ka të hajë, nuk mund ta ushtrojë qytetarinë e vet. Barazia përpara ligjit nuk vlen hiç përballë padrejtësisë sociale. Shteti i së drejtës do të thotë që të mbretërojë ligji, për të gjithë, dhe pa këtë kusht, gjithë të tjerat janë pa vlerë.

Është e kotë të themi se asnjë sistem nuk i ka përmbushur të gjitha këto kushte. Shoqëria demokratike është po aq idealiste sa shoqëria komuniste, por ajo jep më shumë garanci për respektimin e personit se sa shoqëria e përbashkësisë. Aktualisht, vendi ynë po kalon një periudhë tranzicioni drejt shoqërisë demokratike. Në shoqërinë që po ndërtojmë sot, mungon një faktor me peshë, i cili ishte i pranishëm në shoqërinë e mëparshme. Në kohën e komunizmit, ekzistonin komunistët, pra njerëz me një mendësi të caktuar, të cilët përpiqeshin të ngrinin një shoqëri ideale, dhe të jetonin një jetë të caktuar. Ndërsa sot, mund të themi se mungojnë demokratët, pra njerëzit me pikëpamje të mirëfillta demokratike, të cilët do të ishin partizanët e sistemit të ri. Këtu, nuk po flasim për liderët, por për ekzistencën e një shumice njerëzish që mendojnë në mënyrë demokratike. Kjo ka ardhur për shkak të ndërrimit të sistemit, të vazhdimësisë së mendësive të vjetra në një kohë të re, të mungesës së njohjeve në këtë fushë për shkak të izolimit, por mbi të gjitha, për shkak të një përfytyrimi krejt pragmatist të demokracisë, të lidhur më së shumti me aspektin gllabërues se sa me qëndrime të caktuara. Fuqia e parasë është helmi që vret

demokracinë. Ende sot, dëgjohe mendësia: “qeveria nuk po bën asgjë”. Qytetari ende nuk i njeh përgjegjësitë e veta. Ky është handikapi më i madh i tranzicionit të sotëm shqiptar. Vështirësitë e rendit ekonomik janë të lidhura më së shumti me mangësitë në rrafshin mendor. Gjithsekush përpiqet të përfitojë në kurriz të tjetrit.

Në demokraci qeveris shumica, por pushteti real është gjithmonë në duart e një pakice. Pra, ka një fare kontradikte midis pushtetit real dhe atij formal, dhe kjo vjen për shkak të dualizmit politik midis njerëzve dhe institucioneve. Institucioni nuk mund të ekzistojë pa njeriun, dhe cilësia e një qeverisjeje varet nga cilësia e njerëzve, shumë më tepër se sa nga formalizmat institucionale. Edhe në këtë pikë vihet re një lidhje e demokracisë me etikën. Çështjet e etikës demokratike, nuk lidhen përjashtimisht me zënkat dhe të sharat parlamentare apo me pangopësinë e mediave për ngjarje. Etika demokratike lidhet më së shumti me edukimin për të drejtat e njeriut, me respektimin e minoriteteve, me garantimin e dinjitetit ekonomik, me krijimin e kushteve të shprehjes fetare, por më së shumti, me marrëdhënien e qytetarëve me ligjin. Shprehja “nuk ka shtet” nuk duket se mund të jetë kurdoherë një barkë shpëtimi, për mungesën e një marrëdhënieje të drejtë të qytetarit me ligjin dhe sidomos me shprehjen e votës së lirë.

Ajo që është më e rëndësishme dhe që duhet patur gjithnjë parasysh, pra fakti që aktualisht vendet vërtet demokratike janë tepër të rralla, ose mungojnë krejtësisht, nuk duhet të na bëjë të dëshpërohem, as të na pengojë, por të na bëjë që të përvetësojmë disa standarte të njohura, që vende të ndryshme i kanë fituar përmes një pune titanike, ndërsa janë të gatshme, si përvojë njerëzore, për ne, që t’i përdorim në mënyrë të dobishme.

Platoni kishte një koncept për drejtësinë që theksonte më tepër diversitetin e njerëzve se sa barazinë e tyre, pra ai kërkonte vendosjen e tyre në një rend të mirëpërcaktuar, në bazë të cilësive të tyre. Platoni e pranonte diversitetin e roleve dhe gjithkush duhet ta pranojë këtë rend me qetësi. Ky lloj morali në konceptimin e rendit shkon kundër moralit të barazitizmit, të mbrojtur nga Marks. Platoni mendon ndryshe nga Poperi, i cili jep zgjidhjen e kundërt,

pra konkurrimin e lirë. Pikërisht Platonit ia detyrojmë formalizimin e konceptit të qeverisjes së ligjit, që është themelore te modelet e sotme politike. Ndërsa Poperi shkon në skajin e kundërt dhe thotë se forma më e mirë e organizimit shoqëror është ajo që lë hapësirën më të madhe dhe nxit dinamizmin. Ai e mbështet shoqërinë te racionalizmi, por njeriu nuk është vetëm racional. Për të, në shoqërinë e hapur individët janë elementë të pavarur, në konkurrencë mes tyre, ndryshe nga Platoni që u jepte njerëzve më tepër rëndësi se sa institucioneve.

Poperi pranon dy elementë të qytetërimit: racionalizmin e kulluar dhe instinktivizmin shtazor. Poperi ishte një empirist që bazohej vetëm të përvoja, ai e harron aspektin irracional të mendjes njerëzore, që Platoni e vlerësonte. Në shoqërinë e hapur fiton i forti përkundër kolektivitetit, pra racionaliteti humbet. Në të vërtetë, shoqëria njerëzore është organike dhe bashkëpunuese, sepse gjithkush ka nevojë për të tjerët. Mbijetesa e gjithkujt varet nga veprimtaria e mijëra njerëzve, sidomos në shoqëritë e përparuara teknologjikut. Shpesh, konkurrenca e lirë nuk favorizon eficientë, por grumbullimin e pasurive në pak duar. Konkurrenca e lirë e ideve dhe e iniciativave që karakterizon shoqërinë e hapur, funksionon vetëm nëse ekziston një sfond kulturor që e mbështet dhe e rregullon. Pa rregulla etike dhe proceduriale, sistemi degjeneron me shpejtësi. Pa këtë bazë etike, shoqëria përçudnohet në një diktaturë të pak njerëzve mbi shumicën. Para së gjithash, duhet të kërkojmë hapjen mendore për të zhvilluar shoqërinë. Edhe etika kantiane, është e bazuar të disa aksioma, në bazë të parimit të përgjithshmërisë, ku të gjithë subjektet janë të barazvlefshëm. Pranimi i kësaj aksiome është i barabartë me dashurinë universale. Duhet patur parasysh se kur njihet e drejta e lirisë, kjo nuk është një detyrim ligjor, por një hapësirë që pranohet si e tillë. Psh. mund të përmendim shkollimin e detyruar (përdoret fjala e detyruar). Nëse një njeri e lë analfabet, a është i lirë ky njeri në krahasim me të tjerët? Dija është parakushti i lirisë dhe i pushtetit. Edhe ligji duhet parë si një instrument lirie nga ana e vet.

Edhe çështja e barazisë është një çështje etike. Të libri i Oruellit Ferma e kafshëve, thuhet për këtë pikë etike: “Të gjitha

kafshët janë të barabarta, por disa janë më të barabarta se të tjerat”. Kriteri demokratik kërkon që të eliminohen rastet e privilegjeve. Ndaj, tema e barazisë është kapitale. Në demokraci, nuk mund të shkojë asgjë përpara nëse nuk ke pak arsimim, pak punë, pak shëndet dhe ca të ardhura. Etika nuk është një opsion i demokracisë, përkundrazi, ajo na përfshin tërësisht. Individualizmi mund ta kërcënojë etikën, por mund edhe ta ndihmojë atë, sepse etika nuk mund të barazohet krejtësisht me zakonin. Etika është kundër dhunës. Zgjidhjet morale nuk janë si një vizore që aplikohet ndaj realitetit së jashtmi, por ato vetë janë të ngjizura nga realiteti. Etika kryesore në demokraci duhet të jetë etika e komunikimit. Sfida e vërtetë është të dallohet një komunikim që është në gjendje të emancipojë dhe të na çlirojë, nga një komunikim i bazuar te aftësia dhe shtirja. Për këtë, duhen absolutisht strategjet e demokracisë. Ndarja që Makiaveli i bëri politikës nga etika, nuk është më aktuale. Politika duhet t’i kundërvihet dhunës me mjete efikase. Ajo duhet ta kufizojë me efikasitet dhunën ekzistuese, por duhet të shihet edhe drejtimi që po ndiqet. Autoriteti moral është produkt i legjitimitetit. Legjitimiteti është kushti themelor për efektivitetin e qeverisjes, gjë që sjell mirëbesim.

Në epokën tonë, është kryer një ndarje mes sferës së politikës dhe asaj të moralit. Tërësia e vlerave dhe e rregullave që udhëheqin individët në veprimtarinë e tyre duket se ka humbur lidhjet me kriteret që përcaktojnë veprimtarinë e bashkësisë në tërësinë e vet. Kjo ndarje shkakton mënxyra. Përse ekziston politika? Synimi i politikës është ekzistenca, jeta më e mirë dhe më e lumtur e bashkësisë njerëzore të organizuar politikisht. Pra, politikanët janë përgjegjës për këtë bashkësi dhe veprimet e tyre duhet t’i orientojnë drejt këtij qëllimi. Ky është edhe qëllimi i moralit: si mund të ndërtojmë një jetë sa më të lumtur për individët dhe shoqërinë. Edhe jeta individuale në thelb është sociale, askush nuk mund të jetojë vetëm. Kanti ka shkruar se mund të ngrihet një shtet i mirë, një shtet i kënaqshëm, edhe mes djajve. Korrupsioni është diçka që lidhet drejtpërdrejt me etikën në demokraci, sidomos me përdorimin e ofiqeve publike për përfitime vetjake. Aty ku ekziston, korrupsioni luan një rol edhe më negativ se kaq: ai shkatërron karakterin, dhe përmbys rolin që luan ndërgjegjja. Sjellja etike e individit mund të drejtohet vetëm

në një drejtim pozitiv në një klimë institucionale që shpërblen një sjellje etike. Kjo klimë mund të krijohet vetëm kur shoqëria kërkon dhe mbështet standarte të larta në sjelljen njerëzore. Edmond Burke ka thënë: “Një shtet që nuk njuh mjetet e ndryshimit, nuk njuh as mjetet për ruajtjen e vetvetes”.

Pra, rregullimi ligjor nuk mjafton, nevojitet një klimë e tërë mirëkuptimi, si dhe mekanizma të shumëllojshëm që të monitorojnë dhe të hetojnë rastet e abuzimit. Nevojitet një politikë e tërë punësimi në administratën civile, gjë që duhet të shoqërohet me një sistem të mirë shpërblimi. Kjo kryhet përmes transparencës, pra kur qeverisja është e hapur për hetim nga publiku, mediat dhe grupet e interesuara. Së dyti, më e rëndësishme se sa transparenca është lidhshipi, praktika e autoriteteve në sjelljen e tyre. Gjëja e fundit është edukimi dhe trajnimi. Sjellja etike nuk është diçka që mund të imponohet, ajo vjen si një mënyrë e të menduarit kritik, që duhet ushtruar vazhdimisht dhe duhet provuar përmes reflektimit dhe dialogut. Vetëm individët e përgatitur mund të mbajnë etiketën e virtytit; dhe vetëm institucionet që investojnë në një përgatitje të tillë, mund të presin fryte nga investimi i një virtyti të tillë.

Pa një infrastrukturë etike nuk mund të luftohet kundër korrupsionit në sektorin publik. Korrupsioni është një problem administrimi. Integriteti është kushti themelor për një qeverisje demokratike. Korrupsioni nuk është një shkak, por një simptomë e krizës. Ai varet nga faktorët që ndikojnë sjelljen etike në sektorin publik. Ndaj, lind nevoja e infrastrukturës etike, që kërkon standarte të larta sjelljeje. Nuk ka një metodë të mrekullishme për të shpëtuar nga korrupsioni, por ndërthurja e disa masave nxitëse dhe sanksioneve, mund të rrisë standartet profesionale të sjelljes. Shuma e metodave të ndryshme ndërton infrastrukturën etike.

Ajo varet nga kontrolli, nga udhëheqja dhe administrimi. Kontrolli është një dimension rregullator, një aspekt ligjor që siguron një hetim të pavarur në sektorin publik dhe transparencë. Udhëheqja lidhet me lidhshipin, me pergjegjësinë vetjake dhe dhënien e shembullit. Menaxhimi është aspekti i fundit, që mund të kryhet edhe nga organizma jashtë institucioneve shtetërore.

Korrupsioni i prek të gjithë njerëzit dhe është një gangrenë që kërkon ndërhyrje të menjëherëshme kirurgjikale, të paktën në vendin tonë. Si përfundim, mund të sjellim një aforizëm nga Konfuci që kërkonte më shumë etikë në praktikën qeverisëse: “Cilido që ushtron qeverisjen në kuptimin e virtytit, mund të krahasohet me Yllin Polar, i cili rri në vend, ndërsa yjet e tjerë i vijnë rrotull”.

2. Kultura e gruas dhe lëvizja feministe drejt politikës

Miranda Haxhia

Ra porti i pandreqshëm gjinor

Me shprehjen e famshme të Pitagorës: “Është një motiv i mirë që ka krijuar harmoninë, dritën dhe burrin, është një motiv i keq që ka krijuar kaosin, errësirën, gruan;” fillon një prej shkrimeve më të qartë të thellë e të vështirë për raportin midis burrit dhe gruas: Shpesh janë vet gratë që pranojnë një gradë të mirë të ideve maskiliste diskriminuese, kjo është një gjë e ndoshta më e rënda në fund të ndërgjegjësimit të vet realitetit të persekucionit dhe dominimit maskilist. Duke kërkuar eliminim e dallimeve dhe diskriminimin mes sekseve, ajo aspiron që çdo njeri të njohë individualitetin e vet më tej seksit, vet lirinë e qënieve njerëzore. Është kjo arsyeja që në shumë raste raportet që ekzistojnë e krijohen mes problemeve të ndryshme duket se e izolojnë problemin e kushtit social të gruas nga të gjitha fenomenet e ndyra të organizmave sociale, gjeneruar në pjesën më të madhe nga drama e tmerrshme e jetës që ato bëjnë për ekzistencë.

Gratë afër dhe larg politikës

Më shkon mendja për një politikë femërore, natyrisht, mund të jetë një politikë femërore, por çfarë do të ishte një politikë e tillë? Kam parasysh më shumë se një grua që vazhdon të reagojë nga ajo ç'ka mbart, nga fuqia e saj. Në mungesë të fuqisë formale,

shpesh gratë rendin të kapin fuqinë që rezulton mashtruese, manipuluese, është një mënyrë për të bërë politikë, por jo mënyrë e mirë. Problemi kryesor për lëvizjen femministe është si të shkosh ndryshe terrenit të dominuar prej burrave. Një vëmendje sjell e ashtuquajtura etika e vëmendjes. E përdorur sipas shpjegimit të Patricia Collins, si impuls etik i zhvilluar individualisht sipas mënyrës së vet nga çdo njeri. E parë në këtë vështrim kuptoj një orientim të praktikës morale që ka të bëjë me kujdesin dhe vëmendjen. Për sa kohë që gratë janë të pakta në sferat politike, është e domosdoshme që të jenë më afër për të observuar direkt fenomenet politike, për të kapur dhe mbajtur fort mundësitë për pozicionin e tyre shoqëror dhe zhvillimin e temave të mëdha, ku, si, dhe me cilët të përballin anlizat e një kulture të lartë kritike.

Diskutimet e grave intelektuale gjithmonë janë nën petkun e ndershmërisë intelektuale. Në fillim duhet vëzhguar se cili është profili i pjesëmarrjes femërore në politikë, sepse gratë kërkojnë më shumë vëmendje nga personat që janë më shumë të figuruar në ambientet e larta politike, janë të preokupura për cilësinë e jetës për qytetarët e më tej për ata më të ndjeshëm, si fëmijët dhe të moshuarit, janë gratë që hyjnë në politikë me termat e thjeshtë. Në shoqërinë shqiptare është evident shqetësimi për përfaqësim të pamjaftueshëm të grave në politikë, por nuk po shihet ndonjë ndryshim real, ndonjë ndërmarrje apo spostim i mentalitetit të mbartur, qoftë edhe në kuadër të selektimit të emrave që do të konkurojnë në turin e afërt zgjedhor. Madje e parë në këtë kontekst, listat paraprake të kandidatëve për deputete dominohen më shumë se më parë nga meshkujt dhe tek-tuk ndonjë femër.

Ndërhyrja e gruas në jetën politike

Është shumë e nevojshme ndërhyrja e gruas në jetën politike deri sa të konservohet një forcë që të përballojë gjithë rezistencat. Është e nevojshme të krijohen kushte për të punuar si për burrat dhe për gratë. Ky mesazh të bën të reflektosh mbi modifikimet e nevojshme për të pranuar shifrat e gruas në jetën politike. Shumë probleme i pengojnë gratë të hyjnë në politikë, si kontrolli i detyruar i partive politike, ashtu edhe oraret e një politike që duket sikur e veçon nga jeta familjare, por duke menduar që në

gjithë profesionet e tjera, oraret janë të rëndësishme që do të thotë kemi gra mjeke, inxhinierë, arkitekte, duke patur një jetë familjare. Kanë luftuar për të patur të drejtën të zgjidhen.

Vetvetiu të lind pyetja si është e mundur që gratë të jenë kaq të pakta në sferën politike dhe disa nga faktorët i gjej në përgjegjësinë familjare, kushtet e jetës në politikë vendosen nga burrat e jo nga grate, etj. Kjo vlen si për vende të tilla si Franca, Suedia, po ashtu edhe për ne. Për sa kohë që gjejmë një vend modern si Franca që është e shtrënguar të votojë një ligj që të finalizojë dhe garantojë një pjesëmarrje të madhe të grave në politikë është e rëndësishme për demokracinë që gratë dhe burrat të jenë prezantuar në mënyrë të njëjtë në organe vendimore. Duke parë që pjesa më e madhe e shoqërisë janë qeverisur nga një sistem diskriminues kundër gruas: ekzistenca e një hierarkie në të cilën burrat zënë vendet kryesore dhe gratë zbrisin në pozicione nënurdhëruara, duke trajtuar fenomenin në strukturën e shoqërisë; janë rregulla të fshehura që dallojnë burrat nga gratë, ajo që gratë bëjnë, vlen më pak nga ajo që bëjnë burrat, ia vlen të adoptojmë masën pozitive deri në këmbim të sistemit. Të rinjtë politikanë mes tyre dhe gratë duhet të luftojnë për të qënë dëgjuar kur politikanët më të vjetër vendosin për kalendarin.

Po ligji i favorizon gratë?

Edhe pse gratë përfaqësojnë më shumë se gjysmën e popullsisë, sistemi i diskriminimit kombëtar kundër gruas sheshohet në një pozicion të nënurdhëruar. Ky imazh dhe realitet njëherësh nuk ndryshon pa ndihmën e burrave e të grave që e kuptojnë këtë, falë ligjeve, falë kartës qeverisëse, falë aksioneve të partive të ndryshme etj. Normat që aplikohen për grupimin e madh të burrave duhet të jenë të njëjtë edhe për "minoritaret", në rastin tonë gratë. Si mund të shpjegohet që janë kaq pak gratë mes organeve vendimmarrëse? Nuk llogaritet e diskutohet forca e gruas në politikë. Çdo burrë e çdo grua janë kaq të ndryshëm në llojin e vet. Të dyja gjinitë jetojnë njeri pranë tjetrit shpesh duke ndjekur rregullat e jetës kaq të ndryshme. Pra, është vet motivi i demokracisë që i fton burrat e gratë të respektojnë të drejtat e të

bëjnë të mundur të ndihen në shoqëri.

Një konsekuencë e ndryshimit të mënyrave për të jetuar mes burrave dhe grave e që kanë një vështrim kaq të kundërt mbi objektet e shoqërisë do ta bënte më të mirë shoqërinë për të gjithë. Mendoj që nuk është realiste të shpresosh që një ditë do të jetë një barazi vetëm falë sjelljes njerëzore. Në shoqëri, në kulturë janë disa norma që influencojnë atë që e quajmë të pranueshme apo jo të pranueshme. Duhet të jetë gjithmonë nevoja të kontrollohen situatat për të mbajtur rregullin. Në parim ligji premtan të institucionalizojë rregullat ai ofron bazën për kodet e sjelljes. Nga një vështrim aksioni pozitiv lejon të tërheqë vëmendjen e një pjese gjithmonë e më të madhe të popullsisë rreth këtij problemi. Gratë janë në minorancë në politikë, por gratë kanë një mënyrë të ndryshme të të parit të fenomeneve. Gratë janë komunikuese shumë të mira dhe punojnë shumë mirë në ekipe. Janë më të ndjeshme, ajo që duhet konsideruar si një forcë më shumë se burrat, jo si një dobësi. Është shumë e rëndësishme të kesh gratë të prezantojnë nga pikëvështrimi femëror.

Në fushatë elektorale dallimi është etik

Gratë përfaqësohen vështirë në politikë, sepse nuk nohin përgjithësisht mënyrën si të jesh e zonja për të kandiduar. Partitë politike janë makina të komplikuar, të panjohura për shumë prej nesh dhe mundësia për të hyrë në këto parti duhet të jetë më e njohur me anë të informacioneve të ndryshme. Pasi një apo disa gra janë shënuar si kandidatë për forume të larta, fillon dallimi më i madh që ka të bëjë me etikën, moralin dhe sjelljen përballë shoqërisë, votuesve, publikut dhe njeri-tjetrit. Ato duhet të integrohen edhe më masivisht brenda partive për të krijuar një kredibilitet dhe një rritje të mentalitetit. Ndërkaq ka ardhur koha që vetë shoqëria duhet të modifikohet në kontekst me këtë të drejtë natyrale të gruas. Deri këtu jemi dakort, por dallimi bëhet më i madh duke perifrashuar shprehjet dhe demagogjinë e kandidatëve burra në një fushatë elektorale me fleksibilitetin dhe ndjeshmërinë femërore e cila pak a shumë reflekton në fjalime të qarta, të thella, pa fyerje, pa epitete poshtëruese e therëse. Politika e gruas në përgjithësi ka këto dimensione që përcaktojnë kufijtë e etikës dhe

moralit për gjithë shoqërinë, për të mos thënë që është një lloj mase e mirë për të gjykuar sjelljen social-shoqërore të pjesës tjetër, burrave.

Klima politike në përgjithësi paraqet vështirësi për pjesëmarrjen e gruas në politikë, ajo që të shqetëson është nëse këto probleme përdoren si garniturë e politikës formale apo edhe më shumë, kjo ndodh, sepse problemi vjen për të gjitha partitë dhe ato janë përgjegjëse për mos-thithjen e elementit grua në përbërjen e tyre e për t'i lejuar ato të bëjnë karrierë politike. Për sa kohë që këto probleme i lënë të zhvillohen vetëm si fenomene të përkohshme politike, atëherë është një provë e një kulture të mangët të këtyre partive. Pështja sfiduese e fenomenit grua dhe emancipimit të saj është mënyra si prezanton ajo politikën e grupimit që përfaqëson në zonat e saj elektorale. Nëse një qeveri e një vendi nuk është në gjendje të demonstrojë një respekt të qartë në drejtim të të tjerëve, si mund t'u kërkohej të tjerëve të kenë respekt për vete. Të gjitha këto kanë vetëm një shpjegim, gratë vazhdojnë të luftojnë shumë për të drejtat e tyre dhe kur e fitojnë një betejë duan ta mbrojnë me kulturë e moral të lartë, për të krijuar hapësirë për të ardhmen më të lehtë për cilëndo që do të vijë pas të parës.

3. Etika, kultura e komunikimit dhe roli i medias

Zimo Krutaj

Gjithnjë kam menduar se fjala e urtë “fol një herë e dëgjo dy herë” lidhet, më së pari, me raportin natyror që gjithësekush prej nesh e ka njësoj: dy veshë dhe një gojë. Kam përshtypjen se mbajtja parasysh në mënyrë intuitive apo të vetëdijshme e këtij raporti, të dëgjuarit e tjetrit në kuptimin më të mirëfilltë të kësaj fjale, është akti i parë i domosdoshëm i komunikimit normal gjuhësor, e më tutje i marrëdhënieve që krijohen falë këtij komunikimi. Kjo sjell pastaj, vetvetiu, mirëkuptimin e, pse jo, edhe marrëveshjen, duke nënkuptuar gjithnjë respektimin e mendimit të pavarur, pranimin ose jo të argumenteve e ruajtjen e lirisë së tjetrit. A ndodh vërtet kështu, sidomos këto kohë, kur bisedat tona të përditshme, diskutimet, debatet, tryezat e rrumbullakëta apo me cepa, e vecanërisht emisionet, tribunat e mitingjet “alla shqiptarçe”, të shumëfishuara nga media po zhvillohen sipas parimit “Fol, Fol, Vetëm fol!” Pra: a e dëgjojmë vërtet njeri - tjetrin? Apo bëjmë gjoja?! Pa folur pastaj sa pajtohemi ose jo, sa tolerantë, apo të përkujdesur jemi në vlerësimin racional të mendimit të atyre që nuk mund të ndajnë gjithnjë të njëjtin koncept, mendim a qëndrim nga i cili ne e kemi vështirë të heqim dorë.

Duke nisur këtë shkrim më erdhi ndër mend një sekuencë e një emisioni kulturor të ritransmetuar së fundmi, në një nga televizionet kombëtare. I ftuari, një emër i njohur i letrave tona, pasi iu përgjigj për 4-5 minuta pyetjes së rradhës të drejtuesit të emisionit, papritur, i thotë këtij të fundit: “More djalë, më dëgjon

ti mua, apo jo!? Drejtuesi, i zënë gafil, mërmëriti një si “po”, seç tha për skaletën e minutazhin e kufizuar të emisionit dhe kaloi të pyetja tjetër.

Tani le të zhvendosemi në studiot e përnatshme televizive, ku, shembulli me të cilin e nisëm shkrimin është hiçmosgjë, përpara radhës së editorialistëve, analistëve, specialistëve, opinionistëve që, edhe “kur s’rrahin ujë në havan”, dhe dëgjojnë realisht njeri - tjetrin, duke dëshmuar vlera të vërteta jo vetëm të ideve e formulimit, por edhe kulturë komunikimi, “harrojnë” ta bëjnë këtë me publikun, dëgjuesin e tyre besnik, që rri me telekomandë në dorë. Ja që ne, konsumatorët stoikë të menysë së për(dit)natshme mediatike i marrim ende seriozisht ca gjëra. Më mirë se kushdo këtë e kanë kuptuar parlamentarët, të cilët vihen në garë kush e kush të bërtasë, të shajë e të fyejë mbarë e prapë, sapo në sallën e Kuvendit ndizen dritat e kuqe të kamerave. Akoma më interesant e domethënës është raporti folës—dëgjues në tubime të lloj-llojshme, sidomos në mitingjet apo antimitingjet, elektorale, festive apo proteste qofshin. Ndoshta mund të mendohet se këtu duhet ta marrim shtruar, e të zgjatemi me diskutime serioze, ngaqë puna ndërlikohet, për shkak se u dashka të analizojme disa raporte të njëkohshme të foluri, dëgjimi e komunikimi. Për shembull, komunikimi lider-turmë, lider-tribunë, tribunë -turmë, individ -turmë, individ - individ, lider - turmë - publik jo I pranishëm (transmetimet e drejtpërdrejta), etj...etj.

Për t’i shprehur gjërat më thjesht që të kuptojmë më mirë ç’ndodh në kësi rastesh, na vjen në ndihmë një tjetër fjalë e urtë: “Njeri i bie gozhdës, tjetri patkoit!” Një miku im do të shtonte: “I treti i bie kalit mu në ballël!” Pse? Sepse, në asinkron të plotë me njeri-tjetrin, në kohën kur lideri thërret “rroftë!” turma këlthet “poshtë!dhe e kundërta. Po mirë, mund të thuhet, kjo s’ ndodh gjithnjë dhe, kur ndodh, turma nuk miraton thirrjen e liderit dhe shprehe e vetëdijshme kundërshtimin. Jo, jo, turma është e ekzaltuar, nuk dëgjon dhe thjesht ka ngatërruar rradhën e parrullave. Situata është gati -gati e njëjtë si në shembullin e emisionit të sipërthënë përveç faktit të dhimbshëm se këtu nuk realizohet dëgjimi as si akt fizik, organik e i natyrshëm. Merret me mend se ç’mбетet për mirëkuptimin, kulturën e dëgjimit e të komunikimit.

Etika dhe kultura politike e polemikës

Nganjëherë janë pikërisht pyetjet e thjeshta, që të futin nëpër ca labirinte përgjigjesh goxha të vështira. Çfarë i ofrojnë publikut kronikat, emisionet, analizat e opinionet e medias elektronike dhe asaj të shkruar, që kanë në qendër polemikën e debatin për çështje të ndryshme? Pyetja tjetër, e cila nuk mund të mos bëhet, është: Si i serviren “të rejat” publikut (lexues, dëgjues a shikues qoftë), me ç’mjete, etikë e kulturë komunikimi? Përgjigja duhet të jetë e drejtpërdrejtë, se faktet janë domethënëse. Por më duket se, tek ne, reagimet dhe polemikat, me përjashtime të rralla, degjenerojnë në akuza e kundër akuza, në fyerje e anekdota banale, në gërmime biografish, apo në të “treguarit e vendit” për “kundërshtarët”, nga cilado anë qofshin. Për nga forma, fryma dhe mjetet e përdorura kjo farë polemike, nuk i le gjë mangut luftës së nxehtë politike aq të njohur e të pranishme në tranzicionin e stërzgatur shqiptar. Vazhdimisht kam besuar (dhe besoj ende) se intelektualët, njerëzit e letrave, pra edhe gazetarët e opinionistët, do të ishin të fundit që do të shndërroheshin në rinocerontë (sillni në kujtesë veprën e Joneskos). Edhe ndonjë argument, i qëndrueshëm, i përdorur për të nxjerrë në pah vlera, cilësi, risi ose antivlera të çështjeve që shqyrtohen, apo trajtohen në shtyp e në media, tretet në vorbullën e fyerjeve, sharjeve, barcaletave aktuale të historizuara apo anekdotave historike të aktualizuara, të përpunuara enkas e posaçërisht, për t’ia lënë në(n) derë tjetrit... Gjithësecili mbar ekskluzivitetin e së drejtës, të së vërtetës, nuk le pikë dyshimi se mund të ketë edhe një mendim tjetër, qoftë edhe të përfaqësues, ca më pak, larg interesave të drejtpërdrejta vetjake. Toleranca, pranimi i tjetrit, argumenti, profesionalizmi, respektimi i rregullave të etikës, fryma pajtuese, mërgohen tutje, a më mirë mbeten veç fjalë... Kam mendimin se e keqja më e madhe është se, nën hijen e lirisë, a në tempullin e lirisë së fjalës së lirë, mund t’i themi të gjitha, ç’ të duam e si të duam e prapë të kemi bërë një vrimë në ujë.

Çështja bëhet shumë më serioze e shumë më e rëndësishme kur shihet në rrafshin institucional. A mundet, a duhet të dëgjojë dikush në këtë vend, a duhet vënë gishti në tëmtha, qoftë edhe njëherë të vetme në ditë, gjatë orarit zyrtar, nga punonjësit

rogëtarë e drejtuesit e dikastereve apo institucioneve, edhe pse për reagime emocionale apo polemika që ju mungon etika? Themi gjatë orarit zyrtar se aty taksapaguesit kanë të drejtë të mendojnë se gjërat funksionojnë institucionalisht, aty duhet të sendërtohen idetë, programet, projektet e platformat për zhvillimin e vendit, aty dikush e ka për detyrë të marrë në konsideratë mendimin alternativ, të gjejë e të përdorë sadopak vlerat e ideve në vetvete, pamvarësisht nga vijnë. Me sa duket ka ardhur koha që, përveç se të deklarojmë vijueshmërinë apo rezultatet e pritshme të reformave e integritimit në ekonomi e në kulturë, duhet të mendojmë për kulturën e këtyre reformave. Të kulturës në kuptimin real të saj, me ndikim të provuar e të pazëvendësueshëm në formimin e forcimin e vetëdijes kulturore qytetare e kombëtare.

Lajmdhënës dhe kronikanë

Në një kohë e vend të caktuar, çfarëdo lloj reforme, kërkon një kulturë të caktuar që të konceptohet, të kuptohet, të zbatohet e të japë fryte. Natyrisht që kjo gjë s'bëhet përnjëherësh. Thuhet se jemi shoqëri në tranzicion, pra në reformim e sipër. Për kushtet e mendësinë tonë, për zhvillimet e sotme e të ardhme, që integrimi i pritshëm në Europë të mos shtyhet në kalendat greke, tashmë kanë rëndësi jo vetëm reformat e shndërrimet themelore, që kemi marrë përsipër të kryejmë, por edhe kultura e këtyre reformave. Pikërisht që të shpejtohet realizimi i tyre. Në këtë drejtim roli i "pushtetit të katërt" është i pazëvendësueshëm. Le ta shohim rolin e medias në dy rrafshë nga më të rëndësishmit, në të cilat shfaqet qartë kultura e komunikimit, respektimi i publikut dhe etika profesionale: Në dhënien e lajmit dhe në atë që quhet rëndom "kronika e zezë".

- a) Në një vepër kinematografike të mirënjohurit Robert Redfort, në rolin e një gazetari që humbet jetën në punë e sipër, mbyllet me fjalët e protagonistes, e cila e përcakton misionin e gazetarit me fjalët: "Misioni ynë është...të japim lajmin." Në këtë përcaktim të thjeshtë, sendërtohet një kërkesë e domosdoshme, një nga urdhëresat, në mos urdhëresa e parë e gazetarëve, qyshkurse ky profesion është bërë nga më të njohurit, më të kërkuarit, por edhe më të keqkuptuarit a të keqpërdorurit, veçanërisht në

mediat tona elektronike.

Mediat elektronike private, në vitet e para të ekzistencës së tyre, përdorën dhe shfrytëzuan përvojën e RTSH - së, duke krijuar, në mënyrë graduale, hapësira edhe për një lloj tjetër folësi a dhënësi lajmesh: Folësit (folëses) gazetar, më saktë të gazetarëve reporterë, të cilët dilnin në terren, e kërkonin, e ndiqnin, e gjenin vetë lajmin e, më pas, po vetë e përgatitnin dhe e transmetonin drejtpërdrejt në studiot televizive. Nisi, pra, të thyhej tabuja e folësave – meshkuj bukuroshë, të pashëm e simpatikë, apo e folëseve – femra të bukura, të hijshme e zëëmbra, për t'i lënë vend gazetarëve që vinin nga terreni, (madje jo rrallë transmetonin që andej), mbase jo me sharmin e duhur për të dalë në ekran, por me aftësi e të dhëna të mjaftueshme profesionale për ta përcjellë lajmin te publiku me një minimum natyrshmërie. Them minimum, sepse kjo fazë shënon edhe keqkuptimin më të madh të një pjese jo të vogël të folësave nëpër televizionet tona, lidhur me keqpërdorimin e lajmit, (a)logjikës së leximit, të kuptuarit e të kumtuarit e tij, mënyrës së dhënies, marrëdhënies me tekstin, figurën, kamerën e sidomos publikun që i ndjek me telekomandë në dorë.

Dukuria tjetër që shoqëron atë që sapo përmendëm është agresiviteti. Duke mos i nënvlerësuar aspak vështirësitë e punës në televizion, veçanërisht për folësit e përditshëm e të përnatshëm, duke respektuar punën dhe përpjekjet për përmbushjen e misionit të tyre, them se nuk duhet mohuar përvoja e fituar, arritjet pozitive. Kurrsesi nuk marr për shembull gabimet a lapsuset e natyrshme e të kuptueshme, ngecjet për arsye teknike, apo gjendje emotive të pashmangshme. Bëhet fjalë për kërkesa profesionale bashkëkohore, për një kulturë të domosdoshme jo vetëm gjuhësore, leximi e drejtshqiptimi, por edhe komunikimi të natyrshëm, logjik e të besueshëm, gjatë përcjelljes së lajmit te teleshikuesit.

- b) Mediat kryejnë një mision të rëndësishëm, të domosdoshëm e të pazëvendësueshëm në informimin e publikut edhe për atë pjesë të përditshmërisë sonë, që shenohet nën emërtimin

“kronikë e zezë.” Çështja që shtrohet për diskutim qëndron në mënyrën si jepet, paraqitet, prezantohet, apo shkruhet ngjarja e rëndë që vërtet është lajm e i duhet dhënë publikut si i tillë. Pra, thjesht e vetëm si lajm. Në të shumtën e herës, nuk bëhet fare kujdes se ç’ndikim do të ketë tek publiku mënyra e formulimit dhe e dhënies së lajmit. Varësisht prej bashkimit, këndvështrimit, apo trajtimit të këtyre elementëve në mënyrë që të rrisë interesin e të shkaktojë efekt emocional e shokues tek publiku, lajmi për një akt të dhunshëm, duke keqpërdorur objektin e vet, shkakton dhunë tek lexuesit, shikuesit apo dëgjuesit.

Pamjet: gjak, morg, kafka e kufoma të gjymtuara, sopata e thika të gjata, pushkë e kallashnikovë, pistoleta me dhe pa silenciator, granada difensive e ofensive, fishekë e plumba gjithfarësh, portrete të përvuajtur policësh që mbajnë për krahu kriminelë kapadainj, plaka në të zeza që ulërijnë, varrim-çvarrime, etj. (Këto transmetohen, si rregull, jo vetëm në edicionet kryesore të pasdites e të mbrëmjes, por edhe në ritransmetimet e emisioneve të mëngjesit të ditës tjetër. Pra për të gjitha nivelet e grupmoshat e teleshikuesve, përfshi edhe fëmijët).

Teksti: Menyja e mësipërme serviret me një fjalor tejet të rënduar, shoqëruar me një sintaksë djallëzore, duke bërë që gjuha e përdorur në këto lloj kronikash të ngjajë si dy pika shiu me raportet mjeko-ligjore që arkivohen në dosjet e ekspertëve të kriminalistikës. Pa qenë aspak e nevojshme, jepen informacione të hollësishme për lloje e madhësira armësh, plagësh, derdhje trush e copëtime gjymtyrësh, që nuk i shtojnë asgjë të re thelbit të lajmit. Këtu dhuna është e dyanshme. Ndaj publikut dhe ndaj vetë gjuhës. Vetëm po t’i hedhim një sy të shpejtë rezultateve të anketës “Etika në median elektronike”, organizuar nga Këshilli i Ankesave pranë KKRT -së, bindemi se përfundimet e mësipërme janë shqetësuese e duhet të tërheqin vëmendjen e institucioneve përkatëse. Përqindja e të anketuarve që mendojnë se teprohet me shfaqje të dhunës është shumë e lartë. Edhe shifrat e detajuara që i referohen

shqetësimeve të publikut nga dhuna nëpërmjet figurës apo fjalorit janë prapë të larta. (Figura 48. 7 përqind, fjalori 9.8 përqind).

Duam të tërheqim rishtaz vëmendjen mbi ndjeshmërinë ende të lartë të publikut shqiptar ndaj çdo gjëje të shkruar apo të emetuar si lajm në mas-media. Tashmë, edhe të ne, hapësira ligjore, të paktën për transmetuesit radio televizivë nuk është më e mangët. Për median e shkruar, përvoja e viteve të fundit tregon se ligji për shtypin, ose më mirë neni i vetëm i tij, do të ketë nevojë për amendamente, plotësime e saktësime, sidomos në drejtim të asaj që është quajtur “shpërdorim i lirisë”, dhunim i personalitetit e dinjitetit të njeriut, respektim i normave etike e morale. Megjithëkë, asgjë nuk i pengon mediat e botuesit që, në përputhje me legjislacionin për median elektronike apo të shkruar, por edhe si shenjë qytetarie e profesionalizmi, të hartojnë Kode të Etikës e të këmbëngulin për zbatimin e tyre. Këto kërkesa bëhen edhe më imediate në kontekste politike elektorale dhe veçanërisht në periudha kur tranzicioni bëhet më evident për shkak të atmosferave elektorale që shpesh sipas traditës së afërt precipitojnë si konflikte elektorale mes palëve kryesore politike. Në këto kontekste, sipas përvojës së deritanishme mediat kanë dhënë dëshminë e rënies “pre”.

4. Vezhgimi i zgjedhjeve

Dan Redford, Etleva Qinami dhe Eduard Ostrosi

Qëllimi kryesor i një procesi të pavarur vëzhgimi është sigurimi i integritetit i një procesi zgjedhor. Ky objektivi egziston veçanërisht kur zgjedhjet zhvillohen në vendet demokratike në tranzicion. Ky është shumë domethënës në kontekstin e rëndësisë së procesit zgjedhor dhe lidhja e tij me pjesmarrjen e çdo votuesi në këtë proces. Publiciteti, deklaratat publike, si dhe raportet të cilat botohen nga grupet e vëzhgimit mund të rrisin në shkallë të konsiderueshme besueshmërinë e publikut dhe si rrjedhim inkurajimin e qytetarëve për të marrë pjesë në këtë proces, por nga ana tjetër këto mjete mund të çojnë drejt ndryshimit të politikave që nxisin më pas drejt një procesi zgjedhor më të drejtë e transparent.

Prezenca e vëzhguesve përpara, gjatë dhe pas zgjedhjeve ndikon pozitivisht në shmangien e parregullsive, manipulimeve dhe si rezultat i kritikave të tyre reale mund të shpie si rrjedhim në mosnjohjen e rezultateve në qoftë se ky proces do të ishte i paligjshëm.

Duke u bazuar në Nenin 18 të Kodit Zgjedhor të drëjte për të caktuar vëzhgues në zgjedhje kanë:

- Organizatat joqeveritare shqiptare;
- Organizatat e huaja;

Vezhgimi i zgjedhjeve

- Organizatat ndërkombëtare të specializuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- Përfaqësuesit e shteteve të huaja;
- Përfaqësuesit e medias;
- Partitë politike të regjistruara në KQZ si subjekte zgjedhore kanë të drejtë të caktojnë nga një vëzhgues në KZZ, KZQV, KQV dhe në Vendin e Numërimit të Votave;
- Partitë politike të cilat paraqiten si koalicion kanë të drejtë të zgjedhin vëzhguesit vetëm nëpërmjet këtij koalicioni; dhe
- Kandidatët e pavarur në zonat e tyre përkatëse kanë të drejtë të caktojnë nga një vëzhgues në KZZ, KZQV, KQV dhe në Vendin e Numërimit të Votave.

Natyrisht që te drejtat e vëzhguesve të pavarur janë të kufizuara dhe ka disa masa për t'i mbrojtur ato. P.sh. një organizatë joqeveritare shqiptare, parti politike, koalicion ose kandidat i pavarur nuk mund të ketë në të njëjtën kohë më shumë se dy vëzhgues të pranishëm në një qendër votimi. Kjo vlen edhe për organizatat joqeveritare të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare. Ndersa, kandidatët e partive politike dhe koalicioneve nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues.

Vëzhgues të pavarur janë persona të cilët janë të autorizuar nga organizatat joqeveritare që të jenë vëzhgues. Organizata duhet të jetë e regjistruar për mbrojtje të drejtave të njeriut. Vëzhgimi i juaj në qëndrën e votimit do të ndihmojë zbulimin dhe frenojë shkeljen e rregullave të ligjit zgjedhor. Roli i juaj është shumë i rëndësishëm në ndërtimin e proceseve demokratike në Shqipëri. Vëzhguesit e pavarur vendas aktivitetet e tyre i bazojnë në besimin se të gjitha partitë janë konkurrentë të barabartë në zgjedhje. Ata duhet të jenë objektiv dhe të përgjegjshëm dhe të kuptojnë se roli i tyre nuk është të ndërhyjnë në proceset zgjedhore, por t'i vëzhgojnë dhe t'i raportojnë ato me përgjegjësi. Te drejtat e dhe detyrat e vëzhguesve bazohen në nenin 19 të Kodit Zgjedhor.

Rritja gjithnjë e më shumë e vëmendjes në drejtim të një procesi zgjedhor të drejtë e transparent ka prekur gjithashtu dhe fushën e operimeve të vëzhgimit. S'ka shumë kohë që fokusi i aktiviteteve të vëzhgimit nuk është kufizuar vetëm në ditën e zgjedhjeve dhe

gjate procesit të numërimit. Duke e parë në këtë këndvështrim, një vëzhgim efektiv i zgjedhjeve përfshin një mandat më të gjërë që fillon me përgatitjen e statusit që krijon kornizën e zgjedhjeve dhe rezulton në zgjidhjen e ankesave zgjedhore. Krijimi i një kornize ligjore të zgjedhjeve përbën një bazë fillestare për të ndikuar në komponentet e procesit zgjedhor të drejtë e transparent.

Debati në lidhje me ligjin zgjedhor i ofron medias një mundësi të shkëlqyer për të filluar informimin e publikut në lidhje me zgjedhjet e ardhshme. Ligji zgjedhor mundëson në përgjithësi se kush lejohet të shërbejë si vëzhgues zgjedhor dhe çfarë të drejtash ose kufizimesh ka gjatë punës së vëzhguesit. Proçesi vëzhgues i ndërrmarë nga partitë politike, media ose grupet e pavarura duhet të jetë aktiv gjatë gjithë periudhës parazgjedhore. Sapo të perfundojë korniza ligjore, grupet e monitorimit duhet të kontrollojnë procedurat:

- të emerojnë zyrtarët e zgjedhjeve;
- të regjistrojnë partitë dhe votuesit;
- të caktojnë kandidatët;
- të zbatojnë rregullat e fushates zgjedhore;
- të ndjekin votimin dhe numërimin;
- të rishikojnë ankesat;
- të përcaktojnë fituesit e zgjedhjeve.

Proçesi i vëzhgimit nuk përfundon me mbylljen e votimeve dhe atëherë kur rezultatet janë publikuar. Në periudhën paszgjedhore, vëzhguesit duhet të ndjekin pretendimet e parregullsive të dites së zgjedhjeve dhe ankesat e rezervuara nga zyrtarët përkatës zgjedhore dhe gjykatat.

Detyrat e vëzhguesve

Detyrat e vëzhguesve mbështeten në Nenin 19 të Kodit Zgjedhor:

- a. Të respektojnë kërkesat e këtij kodi dhe udhezimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve;
- b. Të respektojnë në mënyrë të paanshme dhe të mos bëjnë

Vezhgimi i zgjedhjeve

- propagandë për asnjë kandidat, parti, koalicion ose alternativë referendare në qendrat e votimit ose në vende të tjera të ndaluara sipas këtij Kodi;
- c. Të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja, si dhe me një dokument indentifikimi të pranuar nga KQZ-ja;
 - d. Të mos mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si mjete propogande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit; dhe
 - e. Të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit dhe administrimit të zgjedhjeve.

Vëzhguesit ndërkombëtarë

Prania e vëzhguesve në zgjedhjet e pergjithshme është një ndihmese e madhe që jepet nga organizma prestigjioze nderkombetare si OSCE ,ODIHR, NDI dhe organizma të tjerë, të cilat kanë për detyrë të:

- Të shërbejnë si dëshmitarë neutralë për të shprehur interesin dhe mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar për zhvillimin normal të proceseve demokratike në Shqipëri;
- Të rrisin ndërgjegjen publike në procesin zgjedhor;
- Të zbulojnë mashtrimet dhe parregullsitë kur ato ndodhin;
- Të vlerësojnë legjitimitetin e një procesi zgjedhor dhe rezultatet në përputhje me rregullat e pranura ndërkombëtare;
- Të rrisin natyren kuptimplotë dhe domethënëse të procesit zgjedhor në vetvete;
- Të rrisin respektin politik, civil dhe të drejta të tjera fundamentale njerëzore në përputhje me parimet dhe përgjegjësite e miratuara në ligjin ndërkombëtar;
- Të bëjnë një vlerësim zyrtar publik të zgjedhjeve dhe të ofrojnë sugjerime për përmirësimin e procesit zgjedhor në të ardhmen; dhe
- Të nxisin pjesëmarrësit politikë të pranojnë rezultatet e një procesi zgjedhor legjitim.

Vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve është fokusuar në tre

funksionë të përgjithshme:

- Kontribut në zgjidhjen e konfliktit;
- Ndihmesë në krijimin e institucioneve demokratike; dhe
- Legjitimizimi i një procesi zgjedhor.

Vëzhguesit partiak

Çdo parti, koalicion ose grup votuesish (propozues i listës) ka të drejtë të caktojë vëzhgues t'i mbikqyrë zgjedhjet. Vëzhguesit partiak kanë të drejta të dhe obligime ndryshme në dallim nga vëzhguesit vendas. Ata i vëzhgojnë zgjedhjet për t'i mbrojtur interesat e tyre politike. Ne në këtë manual do t'i quajmë vëzhgues partiak.

Edukata zgjedhore dhe qytetare

Një tregues i rëndësishëm i ligjerimit të zgjedhjeve është shkalla në të cilën elektorati është i informuar mjaftueshëm dhe në mënyrë të përshtatshme në lidhje me:

- Të drejtat dhe detyrimet e votuesit;
- Datat dhe procedurat e zgjedhjeve;
- Hapësira e mundësive brenda të ciles votuesit mund të zgjedhin; dhe
- Kuptimi i këtyre përzgjedhjeve.

Votuesit marrin informacion në lidhje me të drejtat demokratike dhe zgjedhjet nëpërmjet edukimit qytetar në përgjithësi dhe më shumë akoma nëpërmjet edukimit të votuesit në vecanti. Për këtë arsye Komisioni Qendror Zgjedhor, ministri të vecanta, media të kontrolluara nga qeveria, partite politike dhe organizata civile kanë për detyrë t'ju përcjellin votuesve edukimin e nevojshëm dhe mjaftueshëm. Nuk ka metoda të thjeshta dhe të shpejta me anë të cilës bëhen këto vlerësime. Për të kryer një vlerësim është e nevojshme të përcaktohet niveli kuptueshmërie së votuesit në lidhje me zgjedhjet. Për këtë arsye, ju duhet të përcaktoni në qoftëse mungesa e tyre e kuptueshmërie është e një shkalle të avancuar ose e një natyre të thellë, të tillë që rezultatet e

Vezhgimi i zgjedhjeve

zgjedhjeve nuk do të pasqyronin dëshirën e vërtetë të njerëzve.

Në të tilla kushte, grupet vendase të monitorimit mund të aplikojnë programin e tyre për edukimin e votuesit. Në qoftë se ju mendoni të zbatoni një program edukimi të votuesit, i cili do të jetë më i plotë dhe gjithëpërfshirës, atëhere ju duhet të merrni parasysh se në cilën mënyrë ai lidhet me objektivat e vëzhgimit tuaj. Njohuritë që fiton elektorati në lidhje me votimin dhe vëzhgimin si rezultat i seminareve mbarëkombëtare, buletineve informative, lajmërimeve nga sherbimet publike dhe lajmet ndihmon dhe bën të mundur që votuesit të kuptojnë më mirë të drejtat e tyre dhe si rrjedhim proçesin zgjedhor.

5. Monitoruesit e partive politike

Sue Nelson

Monitoruesit e partive politike janë një komponent thelbësor për të siguruar dhe ruajtur integritetin e procesit. Sipas Institutit Ndërkombëtar për Asistencë Demokratike dhe Elektorale (IDEA):

- Roli i partive politike në vëzhgimin e zgjedhjeve është kritik sepse janë partitë politike ato që kanë interesin më të madh në monitorimin e procesit zgjedhor. Ato janë të pozicionuara mirë për të vlerësuar situatën politike, për të identifikuar barrierat për një fushatë të lirë, implikimet e tipit të sistemit zgjedhor, etj. Përveç kësaj partitë e mëdha të cilat mund të ngrenë një rrjet monitorimi në mbarë vendin, nëpër të gjitha pikat zgjedhore janë shpesh të pozicionuara shumë mirë për të vepruar si parandalues të parregullsive dhe përpjekjeve për manipulim.
- Monitoruesit e partive politike janë agjentët e partive dhe kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhje. Si të tillë, në shumicën e sistemeve, atyre u është dhënë autoriteti jo vetëm për të monitoruar procesin elektorale por edhe për të ndërhyrë nëse besojnë që kushtet ligjore nuk po respektohen. Ata mund të jenë gjithashtu pjesë integrale e procesit administrativ duke u përfshirë në verifikimin dhe regjistrimin e fletëve të votimit nëpërmjet firmave të tyre dhe duke u përfshirë në administrimin e procesit dhe numërimit të voteve. Megjithëse ky rol në shumë sisteme është vullnetar, votimi dhe numërimi

nuk mund të fillojë nëse një nga anëtarët e partisë politike nuk është prezent. Rolet që luajnë monitoruesit dhe kandidatët ndryshojnë. Kandidatët janë protagonistët kryesorë dhe më aktiv të fushatës që punojnë për t'i bindur votuesit të votojnë për ta. Monitoruesit janë vëzhgues dhe nuk duhet të përpiqen të ndikojnë në zgjedhjet e personave që po vëzhgojnë. Monitorimi duhet bërë me drejtësi dhe profesionalizëm. Kodi i sjelljes afrikano-jugor për partitë politike thekson ndryshimin e roleve të monitoruesve nga ato të kandidatëve dhe sesi kandidatët duhet ta lënë procesin e monitorimit në dorë të agjentëve të tyre.

- Prania e vetë kandidatëve krijon rrezik në përshkallëzimin e tensionit dhe konfliktit. Edhe nëse kandidatët nuk sillen në mënyrë kërcënuese, votuesit mund të ndihen të terrorizuar nga prezenca e tyre dhe të humbasin besimin për fshehtësinë e votës së tyre, sidomos në zonat e karakterizuara nga konfliktet dhe violenca partiake. Rrjedhimisht, rregulloret e zgjedhjeve duhet të ndalojnë praninë e kandidatëve brenda perimetrit të brendshëm të qendrës së votimit duke u përshtatur në këtë mënyrë me praktikat ndërkombëtar.
- Agjentët partiakë të mirëtrajnuar mbi aspekte të ndryshme të rregulloreve dhe ligjit për zgjedhjet do të jenë më të aftë të monitorojnë procedimet dhe të mbrojnë interesat e partive. Megjithatë, roli i tyre do të jetë konstruktiv nëse këta agjentë e kuptojnë ekzaktesisht se çfarë pritet prej tyre, cilat janë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre dhe se çfarë u ndalohet të kryejnë. Është roli i partive politike të ndërrmarin hapa drejt sigurimit të një trajnimi të plotë për agjentët e tyre dhe për të siguruar se ata janë të aftë të sillen konform rregullores dhe Kodit Zgjedhor të Sjelljes.
- Për të mbrojtur integritetin e procesit dhe interesat e partisë dhe kandidatit të tyre, monitorët zakonisht:
 - kontrollojnë listat e regjistrimit të votuesve për t'u siguruar që ato janë korrekte; që votuesi ekziston, që ai nuk është regjistruar më tepër se një herë dhe se persona jo të

kualifikueshëm nuk janë regjistruar. Monitoruesit mund të verifikojnë gjithashtu nëse mbështetësit e partisë së tyre kanë mundur të regjistrohen pa ndonjë ndërhyrje apo probleme të tjera;

- bëjnë pyetje menjëherë sapo identifikojnë ndonjë parregullsi apo ngjarje të dyshimtë të ndodhur gjatë regjistrimit, votimit ose numërimit. Nëse nuk merret një përgjigje e pranueshme nga autoritetet zgjedhore duhet të bëhet një ankesë zyrtare me shkrim. Kjo bëhet nëpërmjet procesit zyrtar të ankimit duke përdorur format e posaçme dhe bashkëngjitur të gjitha dokumentet mbështetëse të nevojshme. Një kopje e ankesës së tyre mund t'u çohet partive apo kandidatëve të tyre politikë, organizatave vendase dhe grupeve ndërkombëtare vëzhguese dhe mediave;
- nënshkruajnë dokumentacionin e votimit dhe mbledhin fletët duke verifikuar korrektësinë e informacionit të paraqitur në raporte. Nëse ka ndonjë ndryshim ndërmjet raporteve zyrtare dhe atyre çka monitoruesit kanë vëzhguar, monitoruesit mund të shënojnë mosaprovimin e tyre në një formë zyrtare. Monitoruesit duhet të marrin një kopje të të gjitha dokumenteve që ata kanë nënshkruar;
- ndërmarrin një numërim paralel të votave duke përdorur kopje të fletëve përmbledhëse të mbledhura nga çdo pikë votimi e monitoruar. Numërimi paralel mund të krahasohet me rezultatet zyrtare dhe diferencat të raportohen menjëherë nëpërmjet mekanizmave të zyrtarizuar të ankimit. Kopje të fletëve përmbledhëse për zonat e diskutuara bashkëngjiten fletës së ankimit. Vëzhguesit lokalë dhe ata ndërkombëtarë, ashtu si dhe mediat mund të marrin një kopje të kësaj ankese;
- shqyrtojnë materialet zgjedhore për të verifikuar që ato janë zyrtarizuar dhe në renditjen e duhur. Ky mund të jetë një mekanizëm i tillë si nënshkrimi i pjesës së pasme të fletës së votimit para se ajo t'i jepet votuesit në mënyrë që të certifikohet që është zyrtare dhe e paplotësuar dhe duke

siguruar që vetëm fletët e votimit me firmat e tyre do të numërohen si fletë të ligjshme dhe

- nënshkruajnë rezultatet zyrtare për të verifikuar vërtetësinë e tyre.

Etika e monitorimit

Etika e monitorimit është zakonisht e përfshirë në Kodin e Sjelljes për partitë politike. Sektori i menaxhimit të zgjedhjeve ose sektori i politikave mund të kenë kode të veçanta të sjelljes të cilat mund të aplikohen gjatë formimit të agjentëve partiakë të akredituar si monitorues.

Në përgjithësi për të siguruar integritetin e procesit të monitorimit, monitoruesit:

- I binden ligjeve të vendit, rregullave të sektorit të menaxhimit të zgjedhjeve lidhur me monitorimin dhe rregullave të vendosura nga partitë apo kandidatët e tyre politikë;
- Njohin dhe kuptojnë ligjin elektoral, procedurat dhe kalendarin elektoral;
- Vëzhgojnë në një mënyrë të paanshme dhe jo kërcënuese. Ata nuk mbajnë asnjë lloj arme dhe asnjë prej qytetarëve në votim nuk terrorizohet fizikisht apo verbalisht;
- Ndihmojnë për të lehtësuar administrimin e procesit zgjedhor dhe nuk ndërhyjnë apo shkatërrojnë detyrat rutinë të punonjësve të tjerë zgjedhorë;
- Monitorojnë në mënyrë konstruktive. Vënë në dukje gabimet dhe veprimet e dyshimta të menaxherëve të zgjedhjeve duke argumentuar me fakte dhe me takt;
- Raportojnë vëzhgimet monitoruese me korrektësi dhe bazojnë të gjitha raportet në informacion faktik. Specifikojnë kur informacioni është i pjesshëm dhe i jo i plotë; dhe
- Nuk ndërhyjnë me punën e vëzhguesve të tjerë, monitoruesve të tjerë apo të shtypit.

6. Monitorimi medias në zgjedhet

Robert Norris dhe Patrick Merloe

Asnjë demokraci nuk mund të lulëzojë nëse qytetarët nuk kanë informacionin e nevojshëm për të bërë zgjedhje të lira dhe të mirëinformuara për ata që kërkojnë autoritetin për të qeverisur. Media masive e komunikimit – radio, televizioni dhe botimet – sigurojnë mjetet me anë të të cilave qytetarët marrin informacionin e domosdoshëm për të bërë zgjedhjet politike. Gjithësesi në të gjitha vendet është bërë prezent e njëjta pyetje: “Si mund të sigurohen qytetarët që informacioni që ata marrin nëpërmjet medias është i saktë, i paanshëm dhe i kuptueshëm?”

Në vendet me tradita në demokraci dhe në shtypin e lirë janë zhvilluar një sërë garancish që mbrojnë lirinë e fjalës, lirinë e shtypit si dhe të drejtën e qytetarëve për informim, të cilat i mundësojnë ata të jenë të mirëinformuar nëse dëshirojnë. Po kështu, në demokracitë e stabilizuara, gazetarët profesionistë shpesh kanë nxjerrë rregulla sjelljeje të vetëimponuara që i mbrojnë ata nga tendencioziteti. Këto tradita dhe garanci janë më pak të zhvilluara në ato vende ku sistemet demokratike ende nuk janë forcuar. Prandaj, për qytetarët e këtyre vendeve, është akoma më e rëndësishme të kërkojnë profesionalizëm dhe objektivitet të medias dhe të monitorojnë kronikat mediatike të partive politike, kandidatëve, zyrtarëve dhe çështjeve publike.

Ka disa arsye pse media mund të mos arrijë t'i japë informacionin e saktë dhe të përshtatshëm qytetarëve për

qeverinë, politikat, përfshirë dhe manipulimin e shtypit nga qeverija, vetëçensurimin apo dhe mungesën e standarteve gazetareske. Një projekt monitorues i medias mund të tregojë se deri ku është kompromentuar ajo si dhe deri në çfarë niveli i kryen ajo përgjegjësitë e saj themelore ndaj publikut.

Një projekt monitorimi i medias duhet të fillojë duke shqyrtuar faktorët e mundshëm që çojnë në kronika të papërshtatshme dhe pasaktësi të çështjeve publike. Këto mund të përfshijnë:

- Censurimin direkt;
- Manipulimin e qëllimshëm të medias nga autoritetet qeverisëse;
- Manipulimin e qëllimshëm të medias nga forca të tjera përkrahëse;
- Manipulimin e qëllimshëm të medias nga interesa private;
- Vetëcensurimin e medias që vjen nga frika e ankimit nga qeveria, nga interesat private ose nga kërcënimet aktuale mbi burimet mediatike apo gazetarët;
- Paragjykimet;
- Korrupsionin;
- Aksesin e pamjaftueshëm mbi burimet qeveritare ose politike;
- Mungesën e kopetencës që përfshin dhe moskuptimin e traditës lidhur me të drejtat dhe detyrimet e medias nga pronarët, botuesit dhe reporterët.

Ideja që këto probleme ekzistojnë është një arsye e mjaftueshme për të bërë një përpjekje për monitorimin e medias. Nëse publiku, partitë politike, kandidatët e tjerë nuk kanë besim në media, atëherë një projekt monitorimi për median do t'i shërbente një qëllimi të mirë. Pavarësisht nëse rezultatet përfundimtare të projektit garantojnë një audiencë që mund t'i besojë medias apo t'i nxitin ata të venë në pikëpyetje informacionin që marrin, një projekt monitorues i medias i mirëorganizuar do të jetë një kontribut i vyer në interes të publikut.

Në themelin e vet monitorimi i medias për të mbështetur zgjedhje demokratike konsiston në një vëzhgim të pavarur, të paanshëm të qëndrimit të medias gjatë periudhës së zgjedhjeve.

Megjithëse mungesa e besimit tek media, apo perceptimi i pasqyrimin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm mund të jenë arsyet për të filluar një projekt monitorimi të medias, synimi i një projekti të tillë është të dokumentojë sjelljen e medias në një mënyrë profesionale, sistematike dhe objektive. Në themelin e vet monitorimi i medias për të mbështetur zgjedhje demokratike konsiston në një vëzhgim të pavarur e të paanshëm të qëndrimit të medias gjatë periudhës së zgjedhjeve. Ajo përfshin analizën e aktivitetit dhe/ose pasivitetit të qeverisë për t'i siguruar të drejtën medias për të mbledhur dhe trasmetuar informacionin tek zgjedhësit. Monitorimi i medias përqendrohet në atë që kandidatët të kenë akses jodiskriminues në media për të trasmetuar tek qytetarët mesazhe të mjaftueshme për platformat e tyre, në mënyrë të tillë që votuesit të vlerësojnë ndryshimet midis tyre. Ajo përpiket gjithashtu të provojë nëse qytetarët nëpërmjet medias marrin informacion të saktë e të mjaftueshëm në mënyrë që para kutive të votimit, të bëjnë zgjedhje të mirëinformuara.

Monitorimi i medias ekzaminon nëse pasqyrimi në lajme i kandidatëve, i qeverisë dhe problemeve politike është i mjaftueshëm dhe i paanshëm. Ai ekzaminon gjithashtu edhe pasaktësitë dhe faktorët e tjerë që mund të minojnë zgjedhjet e vërteta politike në ditën e zgjedhjeve. Analizat mund të ekzaminonjë aftësinë e medias të kritikojë aktivitetin dhe/ose pasivitetin e qeverisë dhe të partive politike në pushtet. Ato mund të ndikojnë në funksionimin e pavarur të medias. Në disa vende, monitorimi i medias ka testuar prezantimin e edukimit të votuesve dhe qytetarëve nëpërmjet medias për të përcaktuar nëse ajo është politikisht e paanshme dhe e mjaftueshme të plotësojë nevojat e popullatës për informacion rreth procesit zgjedhor.

Informacion i Dobishëm

Gjatë zbatimit të një projekti monitorimi të medias duhet të kihet parasysh katër çështje kryesore:

- Si vepron qeveria për të garantuar të drejtën e mediave për të mbledhur dhe trasmetuar informacion dhe ide;

- Si vepron qeveria dhe mediat për t'u siguruar akses partive dhe kandidatëve politikë që ata të komunikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe efektive me publikun gjatë periudhës së fushatave zgjedhore;
- Si vepron qeveria dhe media për të garantuar pasqyrim të drejtë dhe të saktë të partive dhe kandidatëve politikë në programet e lajmeve dhe ato informative dhe
- Si vepron qeveria dhe media për të edukuar elektoratin për çështje të tilla si: Si dhe pse duhet të votojë.

Përcaktimi se kush e kontrollon median

Ndërsa mediat kanë disa të drejta të njohura në rang ndërkombëtar për të mbledhur dhe dhënë informacion lirisht, ato gjithashtu kanë përgjegjësi ndaj qytetarëve përsa i përket informacionit që japin. Këto përgjegjësi bëhen veçanërisht të ndjeshme gjatë zgjedhjeve. Përcaktimi se kush e kontrollon median është një nga faktorët kryesorë që duhet të mbahet parasysh përpara se të fillojmë një projekt monitorimi të medias. Duke pasur parasysh të drejtat dhe përgjegjësitë e ndryshme të mediave private dhe shtetërore është e rëndësishme dhe e dobishme që këto dy burime të studiohen veçmas.

Media shtetërore

Televizionet, radiot dhe gazetat pronë apo të kontrolluara nga shteti duhet të jenë në standartet më të larta të saktësisë dhe paanësisë, objektivitetit dhe ekuilibrit. Qeveria në demokraci del nga populli dhe vullneti i popullit është themeli i autoritetit për qeverinë demokratike. Mediat shtetërore për pasojë – ashtu sikurse të gjitha burimet shtetërore – janë pasuri e qytetarëve. Ato duhet të përdoren në shërbim të publikut dhe jo për interesa private apo partiake të një personi apo të një partie politike. Të gjitha mediat shtetërore apo të kontrolluara nga shteti kanë një detyrim të rëndësishëm t'i japin publikut informacion të saktë, të paanshëm, të ekuilibruar pavarësisht nga partia ose partitë politike që janë në pushtet.

Është e përshtatshme madje e domosdoshme për organizatat

qytetare, partitë politike dhe kandidatët të insistojnë në paanshmërinë e medias, ekuilibrin dhe saktësinë dhe t'iu kërkojnë autoriteteve qeverisëse të menaxhojnë median publike në mënyrë të tillë që të mbrojnë të drejtat e qytetarëve për informacionin që ata si votues kanë nevojë.

Media transmetuese private

Disa stacione televizive dhe radio janë private dhe e drejta e pronarit për lirinë e shtypit duhet të përjashtojë ndërhyrjen e qeverisë. Është e vërtetë që media transmetuese private duhet të qëndrojë në standarte të larta për shkak të ndikimit që ajo ka në opinionin publik dhe për vetë natyrën e transmetimit të programeve elektronike. Këto media kanë përgjegjësi etike ndaj publikut për të prezantuar informacion të saktë dhe për pasojë duhet të pasqyrojnë kandidatët politikë dhe çështjet publike në mënyrë të saktë, të paanshme dhe të ekuilibruar. Për më tepër përdorimi i valëve edhe nga interesa private sjell përgjegjësi publike.

Pranohet nga të gjithë se valët janë burim publik. Përdorimi i tyre nga transmetuesi privat i nënshtrohet liçensimit nga qeveria dhe një nivel rregullash për të mbrojtur interesat publike. Interesi i mbrojtjes së të drejtave të publikut për të marrë informacion të mjaftueshëm dhe të saktë për kandidatët duhet të balancohet me të drejtën e transmetuesve privat për të vepruar të pavarur nga rregullat shtetërore arbitrare.

Kjo hedh bazat për të kërkuar: raportime të paanshme; mosdiskriminim në aksesin televiziv që u jepet kandidatëve politikë; dhe së paku atje ku akses i mediave shtetërore është i pamjaftueshëm për të plotësuar interesat e publikut me informacion për zgjedhjet politike; bashkëpunimin për të siguruar kohë transmetimi falas ose të subvencionuar nga shteti për kandidatët politikë.

Media e shkruar private

Kur flitet për paanësi dhe akses, gazetat private trajtohen nga

monitoruesit ndryshe nga mediat shtetërore apo ato publike. Në një mjedis që është i çliruar nga rregulla shtetërore e arbitrare dhe të papërshtatshme, kushdo që ka mundësi financiare modeste mund të shtypë e të shpërndajë një gazetë me mjaft lehtësi.

Megjithatë, ka rëndësi të përcaktojmë nëse qeveria krijon barriera që pengojnë lirinë e shtypit, p.sh.: me anë të kërkesave për liçensim, kufizimeve ose taksave mbi importin dhe aksesin tek lajmi apo pajisjet e shtypit. Një çështje tjetër që duhet kontrolluar është mekanizmi i shpërndarjes së medias së shkruar i cili nganjëherë është shtetëror. Qeveria mund të ndërhyjë në lirinë e shtypit edhe në vendimet që merren për vendin e reklamave të qeverisë dhe të përdorimit të subvencioneve si dhe kërcënimit për t'i mbyllur apo tërhequr këto burime të ardhurash.

Në shumë vende, ka shumë gazeta dhe revista private që prezantojnë lloje të ndryshme pikpamjesh politike. Partitë politike mund të shtypin dhe shpërndajnë gazeta për të parashtruar pikëpamjet e tyre. Natyrisht, gjithmonë mund të lindin pyetje sesa qarkullojnë gazetatat dhe revistat private dhe se ç'përqindje e popullsisë e lexon median e shkruar. Në ato raste kur pluralizmi i medias në praktikë është i kufizuar dhe kur një numër i vogël i medias së shkruar ka një impakt të madh në opinionin publik, nevojitet të bëhet një shqyrtim i hollësishëm për të parë nëse ato i plotësojnë detyrimet profesionale.

Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA)

Instituti Demokratik Amerikan për Çështje Ndërkombëtare (National Democratic Institute for International Affairs), Partnerët për Ndryshim Demokratik (Partnerët Shqipëri), dhe Bordi Ndërkombëtar për Kërkime dhe Shkëmbime (IREX), janë Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA). Sfida përpara Shqipërisë është të adresojë korrupsionin dhe të krijojë një kulturë politike të hapur, pjesëmarrëse dhe transparente. Për ta përmbushur këtë, qytetarët duhet të organizohen për të devijuar fokusin e qeveritarëve nga përfitimet vetjake drejt një shërbimi më të mirë ndaj interesit publik. Konsorciumi DGA, i bazuar në eksperiencën e tij në Shqipëri dhe e gatshme me ide të reja, punon me kolegë shqiptarë dhe ndërkombëtarë për arritjen e këtij qëllimi.

Me mbështetjen e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Konsorciumi DGA ndihmon grupet civile t'i hapin dyert qeverive lokale nëpërmjet organizimit avokacisë dhe përpejkjeve vëzhguese, bordeve organizuese qytetare dhe takimeve publike. OJF-të në nivel kombëtar grupohen bashkë dhe krijojnë mekanizma të fortë për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin legjislativ. Gazetarët rrisin standardet e tyre profesionale dhe u japin qytetarëve informacionin që ata duan për të ndarë opinionet dhe u japin zë ideve të tyre. Partitë politike janë më përgjegjëse ndaj publikut, shtrirjes së qytetarëve, demokratizimit të veprimtarive të brendshme dhe nxit breza të rinj udhëheqës.

Zgjedhjet shqiptare do të bëhen më demokratike kur me qindra qytetarë të marrin pjesë në aktivitetet e planifikuara për të monitoruar procesin zgjedhor. Në të gjithë këto aktivitete, gratë janë pjesëmarrëse të dalluara, kështu që ato mund të luajnë një rol në rritje, të dukshëm dhe të rëndësishëm në jetën publike.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Fletore e demokracisë : etika dhe zgjedhjet/ përg. National Democratic Institute for International Affairs . -

Tiranë : Pegi, 2005 .

42 f. ; 20.7

ISBN 99943-705-6-1

324(496.5)

172(496.5)